

" STATUT I SHOQERISE"

" TechON " SH.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 23/11/2021, personi i meposhtem:

Z. Bledjan Cuni shtetas shqiptar, lindur me 12/11/2001 ne Tirane, (ALB) e banues ne Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me nr. K11112069G, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratoi kete Statut si vijon:

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji 9901/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Kreu II

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 23/11/2021 une, themeluesi i mesiperm, vendosa te krijoj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar " TechON " SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Shoqeria do te kete si aktivitet: Marketing online dhe studime tregu si edhe cdo veprimtari tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 3
Kohezigjatja

Kohezigjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar dhe /
ose e pakufizuar,

Neni 4
Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Muhamet Gjolllesha, Pallatet Zaimaj, Z.Kad 8250, Nr.regj.5984, ish NPV, Kati 2. Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes Shqiperise.

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 LEKE (njqind leke) dhe zoterohet teresisht nga ortaku themelues zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme (100 lek), qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut eshte ne para.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: kontributit ne kapitalin e shoqerise; shitblerjes; trashegimise; dhurimit; cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Cdo disponim ne favor te nje pale te trete nepermjet veprimeve juridike ndermjet te gjalleve duhet te behet ne forme noteriale dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjeseve te kapitalit me kundershperblim, ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personal e permendur ne shkronjat "c" dhe "c" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykates dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproe si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme,

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite,

Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zoterohet nga nje ortak i vetem, ky i fundit do te ushtroje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike, Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes I te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise,

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 le ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12
Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13
Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riprertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandati 5(pese) vjecar emerimi: Z. Bledjan Cuni shtetas Shqiptar, lindur me 12/11/2001 ne Tirane e banues ne Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me nr: K11112069G, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Kreu IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar filion nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjenjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja - Riorganizimi i Shoqerise

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe: kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit;

ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykates,

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket,

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 dale 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar,

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nenshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" TechON " SHPK
Z. Bledjan Cuni

Bledjan Cuni

Bledjan